Aneksi 5 – Kriteret e Kualifikimit dhe Pranueshmërisë

Objekti: Marrje me qira e ambientit për zyra në qytetin e Shkodrës, në kuadër të projektit EAR-MHEWS.

1. PRANUESHMËRIA E OFERTUESVE

Në procedurë kanë të drejtë të marrin pjesë:

a) Persona fizikë individë, të cilët janë pronarë ose disponojnë të drejtën ligjore për dhënien me qira të ambientit.

b) Persona fizikë ose juridikë të regjistruar, të cilët kanë të drejtën ligjore për dhënien me qira të ambientit të propozuar.

Për individët që japin me qira pasurinë e tyre nuk kërkohet regjistrim në QKB.

2. DOKUMENTACIONI I IDENTIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të paraqesë:

- Për individët: kopje të dokumentit të vlefshëm të identifikimit.
- Për subjektet e regjistruara: ekstraktin e QKB-së dhe dokumentacionin e përfaqësimit, sipas rastit.

3. DOKUMENTACIONI I PRONËSISË

Ofertuesi duhet të paraqesë dokumentacion që vërteton të drejtën ligjore për dhënien me qira të ambientit, përkatësisht:

- Certifikatën e pronësisë ose dokument tjetër zyrtar të vlefshëm që provon të drejtën mbi pasurinë.
- Dokumentacionin e nevojshëm të autorizimit ose pëlqimit, në rast bashkëpronësie ose përfaqësimi.
- Dokumentacionin që provon të drejtën për dhënien me qira, kur ofertuesi nuk është pronari i drejtpërdrejtë i pasurisë.

4. DOKUMENTACIONI TEKNIK I AMBIENTIT

Ofertuesi duhet të paraqesë:

- Adresën e saktë dhe të dhënat identifikuese të ambientit.
- Një përshkrim të shkurtër të organizimit dhe gjendjes së tij.
- Fotografi të ambientit, të cilat mundësojnë vlerësimin paraprak.

Përputhshmëria me specifikimet teknike do të vlerësohet sipas kërkesave të përcaktuara në Aneksin 1 – Termat e Referencës.

5. DEKLARATA E OFERTUESIT

Ofertuesi duhet të paraqesë deklaratën sipas modelit bashkëlidhur këtij aneksi, të plotësuar dhe të nënshkruar.

Deklarata do të përfshijë konfirmimin e së drejtës për dhënien me qira, disponueshmërinë e ambientit dhe pranimin e kushteve të dokumentacionit të prokurimit.

6. OFERTA FINANCIARE

Ofertuesi duhet të paraqesë ofertën financiare në lekë, pa TVSH, të nënshkruar nga personi përgjegjës.

Për ofertuesit individë, oferta duhet të përmbajë vlerën bruto të qirasë, tatimin 15% që do të mbahet në burim dhe vlerën neto që do të përfitojë qiradhënësi.

Për subjektet e regjistruara, trajtimi i TVSH-së, kur është i zbatueshëm, do të bëhet sipas legjislacionit në fuqi dhe rregullave financiare të projektit.

7. VERIFIKIMI DHE VLERËSIMI

Autoriteti Kontraktues do të shqyrtojë dokumentacionin e paraqitur dhe do të verifikojë përputhshmërinë e ambientit me Termat e Referencës.

Verifikimi fizik do të dokumentohet me procesverbal.

Ofertat që përmbushin kërkesat minimale do të kalojnë në vlerësimin financiar. Oferta me çmimin më të ulët të pranueshëm do të renditet e para, sipas rregullave të procedurës.